



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD**

---

**GJS-2023-007**

**Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Mejreme Memaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala M. A. nga O., për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë A.Sh.-R., dhe gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë J.M., më 25.05.2023, merr këtë:**

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paraqitur nga pala M.A., ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë A.Sh.-R., dhe gjyqtarit të të njëjtës gjykatë, J.M..

**A r s y e t i m**

Pala – M.A., nga O., me 28 prill 2023, ka paraqitur ankesë ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë A.Sh.- R., dhe gjyqtarit të së njëjtës gjykatë J.M., të cilën ankesë ia ka drejtuar autoritetit jo kompetent, kryesuesit të Këshillit Gjyqësor.

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës më 5 maj 2023, konform nenit 9 par.2 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve e ka përcjellë ankesën tek Gjykata Supreme si autoritet kompetent sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të Kryetaresve të Gjykatave Themelore dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit ( neni 9 par.1 nënpar.1.2 i ligjit të lartcekur).

Parashtruesi i ankesës pretendon se Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë i ka bërë kërkesë me shkrim për me tërheq lëndën prej gjyqtarit J.M., meqë sipas tij ai është i njëanshëm në çështjen e tij, për shkak se e ka leshu masën e përkohshëm, pastaj e ka marrë lëndën dhe ka shkuar në P. të P.N., i cili punon në komunën paralele P., dhe Ç.J., që punon në komunën e

Obiliqit me kryetarin e Komunës – Xh.G.. Të njëjtit ia kanë shit arën (tokën), i kanë shkruar se në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit ta plotësoj padinë kundër të paditurit R.N., në mënyrë që të deklaron nëse i padituri është gjallë apo jo, nëse është në cilën adresë ndodhet, dhe ky ua ka dhënë numrin e telefonit në vend të adresës. Pasi që është shitur ara e kanë gjetur adresën e R.N., dhe caktuar gjykimin me 03.05.2023. I ka kërkuar gjykatës që ta tërheq lëndën prej gjyqtarit dhe dy herë ka kërkuar gojarisht që të bisedoj me kryetaren dhe ka shkruar edhe te prokurori Rr.P., dhe ai e ka përzënë prej zyrës duke i thënë “dil jashtë se toka nuk blihet me 200 DM”. Po ashtu pasi që është shitë toka gjyqtari po kërkon me ja nënshkruar vendimet që i ka marrë në seancë pa të.

Me qëllim të vërtetimit bazës së arsyeshme siç kërkohet me ligj të pretendimeve të lartcekura si autoritet kompetent kam kërkuar nga kryetarja e gjykatës dhe gjyqtari i çështjes që të deklarojnë lidhur me këtë rast dhe kam pranuar deklaratat e tyre.

Në deklaratën e saj lidhur me këtë rast Kryetarja thekson se me datë 22 mars 2023, ka pranuar kërkesën për përjashtim të gjyqtarit J.M., të parashtruar nga paditësi M.A., në lidhje me lëndën C.nr.3463/22. Me 24.03.2023, bazuar në nenin 12.25 të Udhëzimit Administrativ nr.012017, për unifikimin e taksave gjyqësore, paditësit/parashtruesit të kërkesës i është dërguar vërejtja për pagesë të taksës gjyqësore në shumë prej 30.00€, të cilën shumë i njëjti ka qenë i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Bazuar në fletë kthese, vërejtja për taksë gjyqësore është pranuar nga paditësi/parashtruesi i kërkesës me datë 31.03.2023.

Marrë parasysh se gjykata nuk ka pranuar fletëpagesën si dëshmi për pagesën e taksës, konform nenit 5, paragrafi 5.5, pika 5.5.1 të Udhëzimit Administrativ numër.01/17 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore dhe dispozitave ligjore të LPK-së, me datë 28.04.2023, ka nxjerrë aktvendimin GJA.nr.3 85/23, sipas të cilit kërkesa e parashtruar nga paditësi M.A., është hedhur poshtë për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit që ndërlihet me vendimmarrjen e gjyqtarit dhe për mënyrën e vendosjes së çështjes, si kryetare e gjykatës nuk ka autorizim e as mandat të përfshihet në këto çështje, gjyqtari vepron konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi, andaj nuk mund ta komentoj me tepër këtë pjesë, sepse palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë ndaj vendimi të gjykatës së shkallës së parë. Për më tepër, parashtruesi nuk ka qenë i interesuar vet për të vazhduar procedurën e përjashtimit pasi që as nuk e ka paguar taksën e as nuk ka bërë kërkesë për lirim nga taksa (nëse kjo ka qenë arsyeja) ashtu siç e parashohin dispozitat ligjore këtë çështje. Kjo është e gjitha çka ajo si kryetare është në dijeni në lidhje me këtë çështje, lënda është në punë, ku shton se gjatë këtij muaji është mbajtur seance në lidhje me këtë çështje civile, pala çdo herë ka të drejtë të shkruaj dhe të paraqes pakënaqësitë apo dyshime e tij jo vetëm për përjashtim por edhe për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit, për të cilat konfrom dispozitave ligjore do ti shqyrton dhe do ti përgjigjemi me kohë. Deklaratës ia ka bashkangjitur shkresat si: kërkesën për përjashtim të gjyqtarit të parashtruar me datë 22.03.2023; vërejtjen për pagesë të taksës gjyqësore dhe fletë kthesën e pranimit; aktvendimin GJA.nr. 385/23 i datës 28.04.2023.

Kurse, gjyqtari J.M., në deklaratën e tij thekson se në këtë çështje paditësi M.A., nga P, Komuna e O., ka ngritur padi me datën 18.07.2022, kundër të paditurit R.N. nga P., për shkak të vërtetimit të drejtës pronësore në ngastrën kadastrale P... - Zona Kadastrale P., me sipërfaqe prej 16763 m<sup>2</sup>, sipas bazës marrëveshje gojore, me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të ndalimit të shfrytëzimit të paluajtshmerisë ndaj të paditurit. Sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit gjykata pas rishqyrtimit të propozimit përmes aktvendimit ka kërkuar nga propozuesi plotësimin e propozimit, ashtu që gjykatës t'ia paraqes adresën e kundërshtarit të propozimit. Edhe pse propozuesi nuk ia ka paraqitur gjykatës adresën e kundërshtarit të propozimit, gjykata i ka dërguar thirrjen kundërshtarit të propozimit në adresën e paraqitur në padi (fshati P.), pa cekur rrugën dhe numrin e shtëpisë, për seancën gjyqësore të caktuar për datën 03.05.2023. Në këtë seancë është ftuar edhe propozuesi M.A., mirëpo, i njëjti nuk ka ardhur në shqyrtim edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt dhe i njëjti nuk e ka arsyetuar mungesën e tij. Po në këtë shqyrtim nuk ka ardhur as i padituri kurse dërgesa është kthyer me konstatimin se i padituri është shpërngulur. Në këtë situatë procedurale gjykata ka konsideruar se propozuesi e ka tërhequr propozimin, mirëpo, nga shkresat e lëndës gjykata ka konstatuar se nuk ka prova se propozuesi ka pranuar aktvendimin me të cilin është hedhur poshtë kërkesa e tij për përjashtimin e tij, andaj gjykata për shkak të mungesës së kësaj prove ka vendosur që të caktoj një seancë të re sipas propozimit për caktim të masës së sigurimit, dhe të shfuqizoj konstatimin sipas të cilit propozimi konsiderohet i tërhequr.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, deklaratës së kryetares dhe gjyqtarit të çështjes, provave të cilave ia kanë bashkëngjitur deklaratave, vlerësojë se në rastin konkret nuk ka vend për të hapur rast disiplinor ndaj tyre për këto arsye:

Së pari, ankesa është dukshëm joserioze, ngase nuk kemi një përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur ankesa për shkelje disiplinore të kryer nga kryetarja e Gjykatës, pastaj, sa i përket shkeljeve të pretenduara përkitazi me gjyqtarin ato nuk argumentohen.

Se dyti, vlerësoj se ankesa në rastin konkret ka të bëjë me pakënaqësitë e ankuesit rreth vendimeve të marra gjatë procedurës nga ana e kryetares së gjykatës dhe gjyqtarit të çështjes, dhe siç del nga vet ankesa dhe deklarata e të lartcekurve kjo çështje nuk ka marrë ende epilog dhe lënda është në punë. Në këtë drejtim si autoritet kompetent nuk është në kompetencën time të vlerësoj mënyrën e vendosjes se kryetares dhe vendimit të marr nga gjyqtari i çështjes.

Pra, vlerësoj se nga ankesa e paraqitur nuk rezulton asnjë dyshim se kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe gjyqtari J.M., kanë kryer shkelje disiplinore.

Nga arsyet e cekura me lartë, e në bazë të nenit 9 par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 7 par.3 nënpar. 3.1 të Rregullores së Këshillit Gjyqësor, nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Mejreme Memaj  
U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë,
3. Gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë J.M.,
4. Palës ankuese,
5. Arkivit të Gjykatës Supreme.